

## IDRIZ SEFERI (14 mars 1847- 25 mars 1927)

Lidhur me zhvillimet shoqërore dhe historike në Anamorav konstatojmë se një zhvillim i tillë ka rrjedhë në mënyrë intensive prej vitit në vit. Një pjesë e feudaleve dhe sidomos ata më të moshuarit, duke u frikësuar në humbjen e privilegjeve të tyre të dikurshme edhe më tej shpëtimin e kërkonin nga mbështetja tek sulltani dhe Perandoria Osmane. Idriz Seferi me ndikimin e tij kishte arritur që të një pjesë, të paralizojë aktivitetin e tyre, e diku edhe me kërcënime siç ishte rasti gjatë votimit të komisarëve për deputet të parlamentit Osman, më 13 maj 1912.

Nga opozita ishin kandiduar njerëz me autoritet në popull, Hasan Prishtina ne Nexhip Draga. Xhonturqit u aktivizuan që nga qendra në Stamboll kurse Mytezarifi i Sangjakut të Prishtinës erdhi në Gjilan për të propaganduar për kandidatët xhonturk.

Ditën e votimeve, befas në klubin xhonturk u paraqit Idriz Seferi ku i kishte akuzuar xhonturqit me fjalët më të rënda dhe duke treguar dy revolet në brez u ishte kanosur. “ *Derisa t’i kam këto nuk do të lejoj që në Gjilan të bredhin turqit e rinj*”. Kjo deklaratë kërcënuese e Idriz Seferit, sipas konsullit serb në Shkup, Milojeviqit i kishte frikësuar Mytesarifin dhe përcjellësit e tij dhe ata nga frika që herët kishin ikur për Ferizaj.

Në vazhden e përgatitjeve për kryengritjen shqiptare në Kosovë, rëndësi të veçantë kishe mbledhja e krerëve të Kazasë së Gjilanit dhe të anës së Karadakut, në muajin mars të vitit 1910. Kjo mbledhje u organizua me iniciativën dhe u mbajt nën udhëheqjen e Idriz Seferit, patriotit më të dalluar të Kosovës Lindore. Në këtë tubim, në të cilin morën pjesë paria e Gjilanit, Isa Boletini dhe prijës të tjerë nga viese të ndryshme të vilajetit të Kosovës u përcaktuan masat organizative e strategjike të kryengritjes që të fillonte së shpejti.

Ndër zyrtarët e lartë, i cili dha një kontribut të çmuar Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në këto anë dhe ndër bashkëpunëtorët e Idriz Seferit, ishte edhe Kajmekamii i Kazas së Gjilanit, Xhelal beu, shqiptar nga Tërnoci, i cili si kajmekam qëndroi prej 1 marsit të vitit 1910 deri 1 mars 1911. Ky bashkëpunim ishte tejet sekret dhe i vazhdueshëm.

Lidhur me këtë flet edhe burgosja formale e Idriz Seferit, Ramë Abdyli, Shabi Kajollit e disa të tjerëve që ishte bërë diku në mars të vitit 1910 dhe sipas marrëveshjes paraprake mes tyre vetëm sa për të humbur gjurmët e bashkëpunimit dhe të ndihmës që Xhelal beu po i jepte LKSH.

Kontributi i Xhelal beut dhën LKSH ishte i dukshëm. Për këtë flasin të dhënat dokumentare të kohës. Në kohën e masivizimit të kryengritjes më 1910 dhe marrjes së Grykës së Kaçanikut nga ana e kryengritësve shqiptarë. Valiu i Kosovës u ishte drejtuar agallarëve, bejlerëve gjilanas me një telegram, duke i pyetur sa apo ndihmonin kryengritjen.

Pas çlirimit të Shkupit dhe tërheqjes së kryengritësve në viset e tyre, krerët shqiptar filluan zbatimin e vetëqeverisjes, sepse kërkesat e pranuar ishin një perspektiv e bukur për realizimin e atonomisë administrative. Në këtë frymë çdo kund dëboheshin nëpunësit e parpërshtatshëm për t'u zavendësuar më nëpunës shqiptarë.

Si organe të para të pushtetit shqiptar u formuan Këshillat Popullr apo Komisionet, në të cilat merrnin pjesë personalitete më të shquara të kazasë. Komisionet merreshin me shumë çështje, por në radhë të parë kujdeseshin për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë së përgjithshme. Me formimin e Komisioneve ekzistonte një lloj pushteti paralel. Lidhur me këtë situatë, duke lajmëruar kryeministrin Nikolla Pashiq, konsulli serb Milojeviq tregon së në fakt me të shpejtë po shuhej autoriteti i pushtetit osman dhe në vend të tij po ngrihej autoritet i organeve vendëse në krye me krerët e kryengritjes, të cilët ishin shndërruar në pushtet ekzekutiv.

Po ashtu me drejtësinë dhe patriotizmin të cilën posedonte luftoi në evitimin e eliminimit të vëllavrasjeve. Jo vetëm në Kazanë e Gjilanit por edhe në Preshevë, Kaçanik e vende të tjera arriti të pajtonte njerëz. Më fillimin e kryengritjes në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe me thellimin e krizës për çështjen e Lindjes në vitin 1875, debutonin edhe përlëshja e parë e armatosur e Idriz Seferit me organet e pushtetit osman, Idrizi ishte vetem 28 vjeç kur u ballafaqua me çauhin osman, Hysen Ferëm i cili po ushtronte metoda “zullumqare” sipas fjalës popullore, ndaj popullsisë në fshatrat mes Preshevës e Bujanocit.

Në këtë përlëshje u vranë dy bashkëluftëtarët e Idrizt, Kurt Seferi dhe Selim Jaha nga fshati Sefer, Hysen Fera ishte plagosur në këmbë ndërsa Idriz Seferi u plagos në kokë. Idriz Seferi dhe Kurt Tërnavë do të ziheshin rob, të cilët fillimisht i dërguan në spitalin e Vranjës për shërim, mandej në burgun e Nishit ku do të dënohej më 16 vjet burgim për pa dëgjueshmëri, por Gjykata

perandorake e Stambollit e dënoi me 101 vjet burg. Në kohën kur Lidhja Shqiptare e Prizerenit po ushtronte veprimtari të gjerë kombëtare, Idriz Seferi ndodhej në burgun e Nishit. Situata e krijuar nga lufta ruse-osmane e viteve 1877-1878 ndikoi edhe në lirim dhe dëbimin e tij së bashku me të burgosurit tjerë shqiptarë në nëntor të vitit 1877, me rasin e hyrjes së forcave serbe në Nish.

Qarqet shoviniste serbe, ishin të interesuara që Idriz Seferi të zhdukej, sepse ai përbënte një pengesë në rrugën e pushtimit serb të Marovë. Fakti që ai u dënua me një shekull burg tregon se si robëruesit osmanë, ashtu edhe shovinistët serbë, deshën që këtë luftëtar t'ia hiqnin frontit të qëndresës shqiptare në Moravë pikërisht kur po niste Kriza e rëndë Lindore. Me organizmin e Kuvendit të Ferizajit në korrik të vitit 1908, bëheshin përgatitj të mëdha për pjesëmarrjen e një numri sa më të madh kryengritësish shqiptarë të armatosur. Në këtë kuvend kontributin e tij e dha Idriz Seferi, i cili së bashku me Isa Boletinin, Bajram Currin e shumë bashkë luftëtarë të tjerë, ishte ndër udhëheqësit kryesor të Kuvendit të Ferizajit.

Më 20 korrik të vitit 1908 në Stamboll, dërguan telegramin e fundit të firmosur nga 1200 personalitete të shquara shqiptare të gjitha viset e vilajetit të Kosovë. Npërmjet këtij telegrami kërkohëj rivendosja e mënjehershme e Kushtetutës. Ndër të tjera në telegram kërcënohej se, nëse nuk do të realizohen kërkesat do të ornganizohej një kryengritje e madhe me marshin e më se 50 000 shqiptarëve të armatosur drejtë Stambollit. Patriotët shqiptarë ishin të bindur edhe nga përvoja e mëhershme se nuk do të marrin përgjigje të shpejtë nga Stambolli, prandaj pa humbur kohë më 21 korrik, patriotët e lëvizjes shqiptare u nisën drejtë Shkupit në tri drejtime:

Grupi i parë u nis për Tetovë, grupi i dytë për Kaçanik, ndërsa grupi i tretë u nis në drejtimin Gjilan-Preshenvë-Kumanovë. Në këto rrethana, Sulltan Abdyl Hamiti u bind se kauza për rivendosjen e Kushtetutës së vitit 1876 dhe përpjekjet revolucionare shqiptare dhe xhonturke ishin serioze, në këtë situatë më 23 korrik 1908 shpalli Hyrijetin (Lrinë). Menjëherë pas ardhjes në pushtet të osmanëve të rinj, filloi të shtohet në Kazanë e Gjilanit sepse ishte ajo e cila e kishte përkrahur revolucionin xhonturk dhe nga kjo e fundit, u ishte premtuar se me ardhjen e tyre në pushtet do të krijoheshin kushte dhe liri nga disa detyrime. Mirëpo çka ndodhi më tutje, pushteti i ri jo vetëm që nuk e realizoi premtimet e dhena për përmisimin e gjendjes së tyre ekonomike dhe lirim nga detyra, ai veprroi me keq se aq, i ngarkoi fshatarët me taksa të reja plotesuese.

Me rastin e shpalljes së kushtetës edhe shqiptarët u gëzuan dhe mbajtën mitingje për ta festuar. Shqiptarët mendonin se me shpalljen e kushtetës do të bëhej edhe zhvillimi i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

Krahas faktorëve të përgjithshme historike padyshim që tek Idriz Sefer ndikoi edhe mjedisi familjar ku u lind dhe u rrit si dhe kushtet e vështira me të cilat përball ai dhe familja e tij. Ato ndikuan drejtëpërdrejtë që tek ai të rrënjosej ndjenja e atdhedashurisë. Veç kësaj Idriz Seferi pati edhe një tipar tjetër mjaftë të rëndësishme që ishte zgjuarësia e lindurr dhuratë nga natyra. Ky tipar i personalitetit të tij, ndikoi në faktin që ai qysh në moshën 16 vjeçe, të zgjidhej në grupin e burrave të urtë apo pleqnarëve, drejtim në të cilën ai pati mjaftë suksese.

Falë urtësisë së tij, ai arriti të kuptonte se shmangia e përçarjen dhe uniteti i mendimit mes shqiptarëve, ishte faktori kryesor që mund t'i ndihmonte këta të fundit për t'i bërë ballë pushtuesve. Idriz Seferi pati meritë e veçant se arriti të ndërronte bashkëpunimin luftarak e kombatarë ndërmjet tri krahinave të mëdha: Rrafshit të Kosovës, Karadakut dhe viseve përgjat lumit Vardar. Ai ishte i njohur nga viset e luginës së Drinit të Zi e deri në rrethinat e Nishit.

Kryengritja e vitit 1910 ku një kontributë të çmuar dhe Idriz Seferi, që ishte një kthesë e rëndësishme për të gjitha forcat politike të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Në funksion të organizimit të kryengritjes, Idriz Seferi mbajti lidhje të ngushta me Bajram Currin, Hysen Budakovën, Sulejman Batushën, Shaban Biankun e shumë të tjerë. Me nisëmën e Idriz Seferit, në muajin mars të vitit 1910, u organizua në Gjilan një takim i parisë shqiptare të Kosovës Lindore. Në këtë takim u shtrua idja e organizimit të një kryengritje të re shqiptare.

Kryengritja shqiptare e vitit 1910 u shtri në viset e Anamoravës, të Carralevës, të Llapit, Gallapit e Rrafshit të Kosovës, Ferizajit dhe Lumës ku përfshinë mjaftë udhëheqës popullor. Megjithatë territorin e egër xhonturk, Lëvizja Kombëtare Shqiptare nuk arriti të shuhej. Kryengritja e vitit 1910 i dha hov të mëtejshëm zhvillimit të ndërgjegjës kombëtare shqiptare.

Në janar të vitit 1912 Komiteti i Fshehtë i Gjilanit nën drejtimin e Idriz Seferit dhe Sali Kupinës filloi përpjekjet për organizimin e një kryengritje tjetër shqiptare. Gjatë muajve mars-prill 1912 patik takime midis Bajram Currit, Idriz Seferit, Sali Kupinës, Ramë Avdyllit, Islam Pirrës e të tjerëve në fshatrat e Anamoravës për organizimin e kryengritjes. Idriz Seferi mori pjesë në Kuvendin e Junikut që u mbajt në datat 21-23 maj 1912.

Në këtë kuvend ndërmjet atdhetarëve shqiptarë u miratua një platformë autonomiste me 12 kërkesa si dhe u ndanë detyrat. Hasan Prishtina dhe Bajram Curri për Pazarin e Ri, Mitrovicëm dhe Prishtinën, Idriz Seferi dhe Hasan Hysen Budakova u ngarkuan për pjesën e Anamoravës, Gjilanit dhe të Ferizajit. Entuziazmuar shumë nga fitoret që kishte arritur Idriz Seferi, komanfa qendrore e kryengritësve e përgëzoi më fjalët më të ngrohta këtë bir të thjeshtë të Karadakut për fitoret e arritura së bashku me luftëtarët e tjerë.

Ai ishte prijës shumë i shquar i cili përdor taktikën e luftë guerile. Për ta zbuluar situatën në mes shqiptarëve dhe pushteti osman, si dhe për t'u treguar fuqive të mëdha së shqiptarët nuk janë kundërshtarë të saj, vendosi që vetë sulltan Mehmet Rashidi IV-të, të vizitonte Kosovën.

Diplomatët rusë e francezëm zhvillimet në Shqipëri i shihnin në favor të shqiptarëve nga ana e Portës së Lartë, sikur kjo e fundit i jepte koncesione të mëdha shqiptarëve, gjendje e cila shqiptarëve përfundimisht u garantont autonomi, mendim i njejtë edhe i diplomacisë ballkanike, por diskriminuese për popujt e tyre. Në vazhden e koordinimeve të kryengritjes, Idriz Seferi së bashku me kryengritësit e Kazasë së Gjilanit, të Shkupit, Kumanovës e të Preshevës, ishte caktuar që të pengonte depërtimin e ushtrisë osmane nga Shkupi drejtë Rrafshit të Kosovës. Posa mrën lajmin e luftimeve në Shtime e Carralevë, kryengritësit e Kazasë së Gjilanit, të Preshevës e të Kumanovës, të cilët ishin rreth 3000 kryengritës të udhëhequr nga Idriz Seferi, Adel Mustafë Kabashi, Hajdar Demoshi, filluan marshimin drejtë zonës së luftimeve duke treguar një trimëri të rrallë të cilët më 23 prill 1910 ia dolën ta marrin Grykën e Kaçanikut.

Sipas këtij regjistrimi mblidheshin detyrimet tatimore duke përfshi edhe ato të prapambetura. Dhe bëhej rekrutimi i të gjithë meshkujve që i përfshinte detyrimi ushtarak. Për të përforcuar pushtetin e tyre në vilajetn e Kosovës, autoritetet xhonturke, krahas të ashtuquajturave reforma, siç u qujtën masat ndëshkuese, vendosën të bënin këtu edhe disa ndryshime administrative.

Kjo tregon se Gjilani me rrethinë në Kryengritjen e Përgjithshme kundërosmane të viti 1912 ishte jo vetëm një qendër e rëndësishme e tij, por edhe nxitëse për shpërthimin e kësaj kryengritje edhe në vise të tjera shqiptare. Për të bashkërenduar forcat kryengritëse dhe për të hartuar një program kërkesash, realizimi i të cilit do t'i drejtohej Qeverisë së Stambollit, u ndje e nevojshme thirrja e një kuvendi ku do të mblidheshin krerë e drejtues të kryengritjes.